



[WWW..GLOBALALBANIANS.ORG](http://WWW.GLOBALALBANIANS.ORG)

Programi i Projekteve të Fondacionit Global Shqiptar

Përmbledhje

Fondacioni Global Shqiptar (FGSH) ka kënaqësinë të shpallë thirrjen për projekt propozime për organizatat jofitimprurëse shqiptare që dëshirojnë të përdorin platformën tonë të financimit në internet. Ne do të zgjedhim një numër organizatash për të filluar mbledhjen e fondeve në internet për organizata jofitimprurëse në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni Veriore, Mal i Zi dhe Preshevë.

Të gjitha organizatat jo-fitimprurëse inkurajohen të paraqesin propozime dhe do të ketë një tarifë prej 5% për përdorimin e platformës GAF. Ne do të zhvillojmë gjithashtu një uebinar për t'u takuar me organizata jo-fitimprurëse shqiptare. Në këtë uebinar do të shpjegojmë më gjërë se si funksionon platforma dhe do t'i përgjigjemi pyetjeve për ato organizata që preferojnë të presin të paraqesin aplikacionet e tyre për të përdorur platformën.

Kush mund të aplikojë?

Organizatat të cilat dëshirojnë të aplikojnë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Të jetë një organizatë joqeveritare jo-fitimprurëse e regjistruar formalisht me ligj në vendin në të cilin vepron;
2. Të posedojë dokumente regjistrimi (të tilla si një certifikatë regjistrimi, numri fiskal) për të vërtetuar që organizata ka kryer / kryen të gjitha detyrimet e saj ligjore dhe financiare të raportimit;
3. Të pranojë kushtet për përdorimin e platformës online të mbledhjes së fondeve GAF siç përshkruhet në faqen tjetër; dhe
4. Individët, bizneset private, fillestarët, shoqatat tregtare, organizatat fetare, organizatat politike ose partitë, dhe organizatat qeveritare nuk janë të pranueshëm.

Afati i Aplikimit

Propozimet do të përzgjidhen dhe vlerësohen në baza të vazhdueshme. Nuk ka asnjë afat aplikimi.

Kushtet për përdorim të platformës së FGSH për mbledhje të fondeve online

Organizatat duhet të pranojnë se:

1. GAF nuk do të dhurojë para për organizatat ose të garantojë se do të marrë donatorë - GAF është një platformë për çdo organizatë jofitimprurëse shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni Veriore, Mal të Zi ose Preshevë për të mbledhur para online;
2. Përgjegjësia është e organizatës të krijojë dhe të shpërndajë fushatën e mbledhjes së fondeve. GAF do të ndihmojë në një farë mase dhe do të sigurojë udhëzime të hollësishme me shkrim se si të organizojmë një fushatë efektive për mbledhje fondesh online për organizatat e miratuara, mirëpo organizatat priten të jenë proaktive dhe dinamike në përpjekjet e tyre për mbledhjen e fondeve;
3. Platformat kryesore për mbledhjen e fondeve në internet do të jenë Facebook dhe faqja e internetit e GAF, dhe GAF do të sigurojë informacion për të gjitha organizatat e zgjedhura se si njerëzit që të cilët nuk kanë mundësi të dhurojnë në Facebook (i cili përfshin të gjithë që jetojnë në rajonin e Ballkanit) mund të dhurojnë edhe përmes platformave si PayPal Giving Fund (me kusht që ata të kenë një llogari Paypal);
4. Nuk do të ketë ndonjë preferencë të veçantë për ndonjë sektor të caktuar si shëndetësia, fëmijët, mjedisi ose arsimiti, etj.. - të gjitha organizatat joqeveritare dhe jo-fitimprurëse janë të pranueshme dhe ne do të vlerësojmë secilën për meritat e tyre, ndërsa në të njëjtën kohë do të përpiqemi të kemi një ekuilibër të organizatave që adresojnë një larmi çështjesh në zona të ndryshme gjeografike;
5. Organizata duhet të ketë një projekt specifik për të mbështetur - GAF nuk do të mbështesë fushatat e mbledhjes së fondeve që synojnë mbështetjen e shpenzimeve të përgjithshme të një organizate ose për blerjen e pajisjeve, automjeteve, pasurive të patundshme ose sendeve të tjera që nuk konsiderohen të nevojshme për zbatimin e projektit;
6. Një kontratë do të nënshkruhet nga GAF dhe organizata joqeveritare përpara se të fillojnë çfarëdo përpjekje për mbledhjen e fondeve në emër të organizatës duke përdorur platformën GAF dhe një tarifë prej 5% do t'i ngarkohet organizatës për të përdorur platformën GAF; dhe
7. Organizata duhet të plotësojë një [formular aplikimi](#) në internet që zgjatë më pak se një orë. Çdo aplikim i paraqitur në ndonjë formë tjetër do të refuzohet. Çdo pyetje mund t'i drejtohet tek emaili: grants@globalalbanians.org.

FONDACIONI GLOBAL SHQIPTAR

(FGSH)

PËRSHKRIM I SHKURTËR I FONDACIONIT

Fondacioni Global Shqiptarët është një fondacion që u krijua në Shtetet e Bashkuara në Qershor 2018, dhe që synon të promovojë Filantropinë Shqiptare - si nga diaspora e madhe shqiptare, ashtu edhe nga shqiptarët që jetojnë në vendet e tyre. Misioni i tij është të promovojë financimin, zhvillimin dhe menaxhimin profesional të organizatave jofitimprurëse shqiptare.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Preshevë janë të ftuar të aplikojnë për të përdorur platformën GAF për mbledhjen e fondeve. Nuk ka asnjë pagesë për të përdorur platformën.

FGSH do të ndihmojë organizatat jo-fitimprurëse të mbledhin fonde si mëposhtë:

- Sigurimi i një lidhjeje të besueshme me një organizatë me bazë në Diasporë (GAF) që do të besohet nga donatorët e ardhshëm shqiptarë dhe jo-shqiptarë për të kontrolluar organizatat pritëse për besueshmërinë, kompetencën, ndikimin dhe transparencën;
- Sigurimi i një mekanizmi për dhurimet në internet i cili aktualisht nuk ekziston për pothuajse të gjitha organizatat jofitimprurëse me seli në Ballkanin Perëndimor dhe kështu lehtëson shumë mbledhjen e donacioneve dhe ul kostot e filantropisë; dhe
- Sigurimi i një mekanizmi për donatorët e Diasporës Shqiptare për të marrë zbritje në taksat për donacionet e tyre që nuk mund t'i marrin nëse dhurojnë drejtpërdrejt për organizata jofitimprurëse shqiptare në Ballkanin Perëndimor.